



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Në mbështetje të nenit 150 të Statutit të OAK-së Këshilli Drejtues i OAK shpallë

K O N K U R S

Për vend të lirë të punës

Pozita: Zyrtar/e për Informim-Komunikim
Koeficienti: 7.5

I. Kushtet: Përveç kushteve të përgjithshme:

Kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të ketë të kryer Fakultetin e gazetarisë, juridik, komunikimin masiv apo degëve tjera të ngjashme (katërvjeçar ose bachelor + master)
2. 3 (tre) vite përvojë pune;
3. Njohja e punës ne kompjuter (Programet e Windows-it) e obligueshme
4. Njohja e gjuhëve zyrtare (njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme)
5. Të kandidatët do të vlerësohen: afinitetet, kreativiteti, shkathtësitë profesionale, aftësia për të përballuar punën nën presion.

II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

- Në koordinim me zyrën e kryetarit dhe Drejtorin Ekzekutiv, mbulon përgjegjësitë në fushën e informimit;
- Organizon/planifikon të gjitha aktivitetet nga fusha e informimit, përfshirë konferencat me gazetarë, prononcimet për media, takimet e kryetarit dhe të zyrtarëve tjerë si dhe njofton opinionin për aktivitetet e OAK-së;
- Planifikon dhe përgatitë publikimet dhe aktivitetet e tjera periodike dhe ditore me qëllim të informimit të qytetareve dhe transparencës para tyre të OAK-së;
- Koordinon dhe përgatitë buletinët dhe broshurat informative si dhe shkrimet ne web-portalin e OAK;
- Përgatitë politikën e informimit;
- Arkivon të gjitha materialet nga fusha e informimit, ndjekë dhe monitoron shtypin ditore dhe atë elektronik;
- Harton raporte mbi aktivitetet e OAK-së;
- Njofton mediat për ngjarjet ne OAK-së;
- kryen punë të tjera me të cilat e ngarkon Drejtori Ekzekutiv apo Kryetari i OAK.

KOHËZGJATJA E PUNËSIMIT:

Periodha provuese prej 6 (gjashtë) muaj.

DATA E MBYLLJES SË KONKURSIT:

Konkursi është i hapur (15) pesëmbëdhjetë ditë prej ditës së shpalljes në gazetatat lokale dhe në web faqen e Odës së Avokatëve të Kosovës www.oak-ks.org. Afati i fundit është më datë 25 Gusht 2020.

PARAQITJA E APLIKACIONIT:

Aplikacionet merren me rastin e dorëzimit të dokumenteve në OAK, në zyrat e Odës së Avokatëve të Kosovës, Rr. “Bedri Pejani” nr.31, Prishtinë.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet të tjera të nevojshme. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen.

Kandidatët të cilën hynë në listën e ngushtë, për testim dhe intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Odën e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, rr.Bedri Pejani nr.31

Për informata më të hollësishme të interesuarit mund të na drejtohen me anë të E-mail adresën: info@oak-ks.org ose në numrat e telefonit: 038/244 -586 dhe 038/243-717, prej orës 08:00 – 16:00.

Kërkesat e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.